



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 6 paragrafët 1, 2 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore, dhe neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, nxjerrë,

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË OJQ-ve PËR LICENCIM SI QENDRA RINORE PUBLIKE

Neni 1

Themelohet Komisioni ad-hoc për shqyrtimin e kërkesave të OJQ-ve, për Licencim si Qendra Rinore Publike në Komunën e Podujevës, në këtë përbërje,

1. **Agim Idrizi**, *përfaqësues nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit*, kryesues
2. **Kadrie Ajvazi**, *përfaqësuese nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave*, anëtare
3. **Donjetë Sheqiri**, *përfaqësuese nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal*, anëtare

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij Vendimi, pas shqyrtimit të kërkesave të OJQ-ve, për Licencim si Qendra Rinore Publike në Komunën e Podujevës, përgatit në formë të shkruar raport me rekomandime, dhe të njëjtin ia paraqet Kryetarit të Komunës, përmes drejtoreshës të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

u dërgohet;

- Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
- Anëtarëve të Komisionit,
- Arkives

Nr.prot. 02-020/04-0085534/19
Podujevë,
04 nëntor 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga ana e Komisionit, të përzgjedhjes së OJQ-Klubeve sportive për financim publik të programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve sportive, sipas Thirrjes publike të dt. 12.09.2019, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ-KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të OJQ-Klubeve Sportive për realizimin e programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve sportive, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme 10,000.00 €.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të projekteve si dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve të mbështetjes financiare është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/03-0085510/19
Podujevë, 04 nëntor 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 49 parag. 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, nxjerr:

VENDIM PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 1

1. Themelohet Komisioni disiplinor në administratën publike të Komunës së Podujevës.
2. Përbërja e komisionit është:

Halit Vërshevc, udhëheqës i sektorit të shëndetësisë,	kryesues
Blerim Nishevc, zyrtar i lartë i personelit,	anëtar
Shkurte Musa – Fazliu, zyrtare për shërbim me qytetarë,	anëtare

Neni 2

Funksioni dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 dhe aktet nënligjore që i referohen fushës së veprimit të këtij ligji.

Neni 3

Komisioni themelohet në mandat tre vjeçar.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Zyrës së Personelit
Arkivit

Nr. 02-020/04-0086459/19
Podujevë, 06 nëntor 2019




Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 4.6 të Rregullores MF-nr. 03/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore dhe nenet 16 dhe 17.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JO FINANCIARE NË PRONËSI TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Për inventarizimin e pasurisë jo financiare të Komunës së Podujevës, ngritët komisioni në këtë përbërje:

- | | |
|-----------------------|----------|
| 1. Ramadan Zymeri | kryesues |
| 2. Florentina Stublla | anëtare |
| 3. Xhyllfidane Nimani | anëtare |
| 4. Venoza Zullufi | anëtare |
| 5. Halit Vërshefci | anëtar |

Mandati i komisionit është dy (2) vite.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Rregullore MF-nr. 03/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni i paraqet raport Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

Neni 4


Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi për ngritjen e komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare në pronësi të komunës së Podujevës Nr. 02-020/04-0091575/18, datë 23 nëntor 2018.

Vendimi shfuqizohet për shkak të pensionimit të një anëtari të komisionit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-020/04- 0086727/19
Podujevë, 08 nëntor 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës së Klubit të Karatesë “Llapi” nr.09-615/03-0085204/19 të datës 01.11.2019, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, me kërkesën nr. 02-400/04-0088279/19, datë 14.11.2019, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE KLUBIN E KARATESË “LLAPI” NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Klubi i Karatesë “Llapi” për pjesëmarrje në garat e Kampionatit Ballkanik, i cili do të mbahet në Llashko të Sllovenisë, nga data 06 deri më 08 dhjetor 2019, mbështet me mjete financiare në shumë 500 €.

Neni 2

Mjetet buxhetore sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve n’kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e Klubit të Karatesë “Llapi” – Podujevë.

Neni 3

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Nr. 02-400/04-0088279/19
Podujevë, 14 nëntor 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L – 040, nenet 16 dhe 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në kërkesë të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr.02-400/04-0088284/19, datë 14.11.2019 merr:

VENDIM PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR ORGANIZIMIN E MANIFESTIMIT - ZGJEDHJA E SPORTISTIT TË VITIT 2019 NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Lejohen mjete financiare për realizimin e Manifestimit-Zgjedhja e Sportistit të vitit 2019, organizuar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në Komunën e Podujevës, në shumë 2000 €.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe destinohen për realizimin e aktiviteteve sportive, sipas specifikacionit përkatës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit e cila obligohet për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore për realizimin e këtij manifestimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/04-0088284/19
Podujevë, 15 nëntor 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L – 040, nenet 16 dhe 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në kërkesë të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit nr.02-400/04-0088288/19, datë 14.11.2019 merr:

VENDIM
PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR ORGANIZIMIN E
MANIFESTIMIT TRADICIONAL - TAKIMET E KULTURËS “ KADRI
KADRIU” 2019

Neni 1

Për organizimin e Manifestimit Tradicional -Takimet e Kulturës “ Kadri Kadriu” 2019, lejohen mjete financiare, në shumë 1100 €

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe destinohen për realizimin e manifestimit të cekur, sipas specifikacionit përkatës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit e cila obligohet për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore për realizimin e këtij manifestimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/04-0088288/19
Podujevë, 15 nëntor 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu